Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 25 qershor 2014

Lënda nr. 331/09

Nebojsha MILLADINOVIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 25 qershor 2014, me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në pajtim me rregullën 13 § 2 të Rregullores së punës, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur dhe është regjistruar më 4 dhjetor 2009.

2. Me një vendim të 15 shtatorit të vitit 2011, Paneli e bashkoi ankesën me dhjetë ankesat tjera (ankesat nr. 172/09 dhe të tjerat) dhe i shpalli ato pjesërisht të pranueshme.

3. Më 22 shtator 2011, për ankesën u njoftua Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për komente të UNMIK-ut lidhur me pranueshmërine e ankesës. Më 28 tetor 2011, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

4. Me një vendim të 16 dhjetorit të vitit 2011, Paneli vendosi ta ndajë ankesën e z. Nebojsha Milladinoviq nga ankesat e tjera.

5. Më 4 prill 2012, Paneli kërkoi nga ankuesi që të ofrojë informata shtesë. Më 12 prill 2012, Paneli pranoi informata nga ankuesi. Më 3 tetor 2012, Paneli kërkoi nga ankuesi që të ofrojë informata shtesë; megjithatë nuk është pranuar asnjë përgjigje.

6. Më 14 mars 2013, Paneli e shpalli ankesën pjesërisht të pranueshme.

7. Më 2 prill 2013, Paneli ia përcolli vendimin e vet PSSP-së, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesës dhe gjithashtu kopjet e dosjeve relevante për rastin. Më 26 prill 2013, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

8. Më 23 qershor 2014, Paneli pranoi sqarim nga ankuesi.

II. FAKTET

9. Ankuesi është ish-banor i Kosovës, i cili tani jeton në Serbi. Ai pohon se është pronar i shumë ngastrave kadastrore që ishin në pronësi të babait të tij, duke përfshirë ndërtesa rezidenciale, bujqësore dhe ndihmëse dhe pemishte në fshatin Miraqë, Komuna e Vushtrrisë, dhe në qytezën e Vushtrrisë. Në mënyrë specifike, prona në fshatin Miraqë përfshinte një vilë kurse prona në Vushtrri përfshinte një shtëpi.

10. Ankuesi deklaron se babai i tij jetoi në pronën e lartpërmendur rezidenciale deri në vitin 1999, kur ai u detyrua të largohej për shkaqe sigurie. Ankuesi deklaron se ai ishte informuar se vila në Miraqë ishte shkatërruar në vitin 2002, ndërsa shtëpia në Vushtrri ishte uzurpuar. Më 28 gusht 2006, me vdekjen e babait të tij, ankuesi trashëgoi të drejtat në pronat e përmendura më lart.

11. Më 25 maj 2005, babai i ankuesit paraqiti një kërkesë për kompensim para Gjykatës Komunale në Vushtrri kundër Komunës së Vushtrrisë, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pronës së tij. Ai i kërkon 152,800 euro si kompensim për këtë dëm.

12. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata Komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar asnjë seancë dëgjimore. Ankuesi deklaron se deri më tani ai nuk kishte marrë ndonjë vendim nga Gjykata Komunale e Vushtrrisë lidhur me kërkesën e tij.

13. Përafërsisht 17,000 kërkesa për kompensime janë paraqitur në vitin 2004 para gjykatave kosovare, pjesa më e madhe nga serbët etnikë, të cilët për shkak të armiqësive ishin larguar nga Kosova në vitin 1999 dhe prona e të cilëve ishte dëmtuar apo shkatërruar më vonë. Me qëllimin që të përmbushin limitin kohor prej pesë vjetësh të parashikuar me ligj për paraqitjen e kërkesave civile për kompensim, paraqitësit e kërkesave për kompensime dorëzuan kërkesat e tyre për kompensim rreth kohës së njëjtë në vitin 2004. Kërkesat për kompensim iu drejtuan kombinacionit UNMIK, KFOR, IPVQ dhe komunë përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), *Millogoriq dhe të tjerët*, lëndët nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendimi i datës 24 mars 2010, § 1; për bazën ligjore në të cilën paraqitësit e kërkesave bazuan ankesat e tyre, shih mendimin e njëjtë, § 5).

14. Në lidhje me këto raste, më 26 gusht 2004, drejtori i Departamentit të Drejtësisë i UNMIK-ut (DD) u dërgoi një letër të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe të qarkut dhe

kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Në letër, drejtori i DD-së përmendi se "mbi 14,000" kërkesa të tilla për kompensim janë paraqitur. Ai iu referua "problemeve që një valë e tillë e madhe do të paraqesë për gjykatat", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos caktohet derisa të ketë një kohë të tillë ashtu siç ne së bashku e kemi përcaktuar për shqyrtimin e këtyre rasteve" (për tekstin e plotë të letrës, shih *Millogoriq dhe të tjerët* mendim, i përmendur në § 13 më lart, në § 6).

15. Më 15 nëntor 2005, DD-ja u kërkoi gjykatave të fillojnë me shqyrtimin e kërkesave për kompensim për dëme të shkaktuara nga personat e zakonshëm të identifikuar dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit të vitit 2000, duke konsideruar se "pengesat për shqyrtimin efikas të këtyre rasteve" nuk ekzistonin më tutje. Kërkesat për kompensim lidhur me ngjarjet që i takojnë periudhës para tetorit të vitit 2000, nuk u prekën nga kjo letër.

16. Më 28 shtator 2008, drejtori i DD-së këshilloi gjykatat se rastet që nuk janë caktuar për shqyrtim sipas kërkesës së 26 gushtit të vitit 2004 të shqyrtohen tani.

17. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me Policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

III. ANKESA

18. Duke pasur në konsideratë shpalljen e ankesës të pranueshme, ankuesi, në esencë ankohet se procedurat lidhur me kërkesën e tij për kompensim për pronën e dëmtuar janë pezulluar, dhe kështu ia kanë bërë atij të pamundshme të marrë vendim për kërkesën e tij, në shkelje të së drejtës së tij për qasje në një gjykatë sipas nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ai gjithashtu ankohet se, si rezultat i pezullimit, procedurat nuk kanë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, në shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Në fund, ai pohon se për të njëjtën arsye e drejta e tij për kompensim efektiv sipas nenit 13 të KEDNJ-së është shkelur gjithashtu.

IV. LIGJI

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së

19. Paneli thekson se rasti i ankuesit ngrit çështjet lënda e të cilave tanimë i është dorëzuar Panelit nga ankuesit e tjerë. Paneli rikujton se në, për shembull, rastet e bashkuara *Millogoriq dhe të tjerët* (përmendur në § 13 më lart), ai shqyrtoi ankesat nga pesë ankues, të cilët ishin gjithashtu pronarë të pronës së paluajtshme në Kosovë. Në vitin 1999, duke pasur frikë nga armiqësitë, ata gjithashtu u larguan nga shtëpitë e tyre në Kosovë. Prona e tyre ishte dëmtuar apo shkatërruar gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999, pas hyrjes në Kosovë të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Këta ankues i paraqitën kërkesat për kompensim në vitin 2004 para gjykatave kompetente komunale kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunave përkatëse, duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj pronës së tyre. Ata gjithashtu nuk ishin kontaktuar nga gjykatat dhe nuk ishin caktuar seanca gjyqësore, për shkak të intervenimit të lartpërmendur të DD-së që pezullonte procedurat gjyqësore prej

gushtit të vitit 2004 deri në shtator të vitit 2008. Në këto raste, Paneli përfundoi se e drejta e ankuesve për të pasur një vendim nga gjykatat për kërkesën e tyre është shkelur.

20. Në përgjigjen e tij PSSP-ja ofron argumente të detajuara, të bazuara në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. PSSP-ja argumenton në mes tjerash se kërkesa e UNMIK-ut që procedurat të pezullohen duhet konsideruar të kenë pasur qëllim legjitim, dhe që në rrethanat e Kosovës së paskonfliktit dhe sistemit të saj gjyqësor në zhvillim, pezullimi i përkohshëm ishte mënyra e vetme për UNMIK-un që të merret me situatën e jashtëzakonshme me të cilën ndeshej sistemi gjyqësor i Kosovës, të shkaktuar nga vala e kërkesave për kompensim. PSSP-ja argumenton se kishte një proporcionalitet të arsyeshëm në mes mjeteve të përdorura dhe qëllimit të kërkuar për t'u arritur, sepse një balancë e drejtë ishte krijuar në mes kërkesave të një interesi të përgjithshëm të shoqërisë dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave fundamentale të individit. Sipas PSSP-së, arsyeshmëria e zgjatjes së procedurave duhet vlerësuar në dritë të rrethanave të veçanta të rastit, dhe Gjykata Evropiane zbaton tri kritere në veçanti: sjelljen e autoriteteve gjyqësore, kompleksitetin e rastit dhe sjelljen e paraqitësit të ankesës. Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit shkaktojnë shkelje të kërkesës për kohë të arsyeshme. PSSP-ja analizon në detaje aplikimin e kritereve të mësipërme në kontekstin e Kosovës aq sa kanë të bëjnë me ankuesin.

21. Paneli rikujton se ai tanimë i ka shqyrtuar dhe hedhur poshtë të gjitha këto argumente në *Millogoriq dhe të tjerët* (përmendur në § 13 më lart), në *Berisha dhe të tjerët* (PKDNJ, lëndët nr. 27/08 dhe të tjerët, mendimi i 23 shkurtit të vitit 2011, § 24) dhe në *Laliq dhe të tjerët* (PKDNJ, lëndët nr. 30/08 dhe të tjerët, mendimi i 13 majit të vitit 2011, § 21). Për sa i përket argumentit se rrethanat në Kosovë duhet marrë parasysh, Paneli ka gjetur se është e vërtetë që karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ngjashme duhet marrë parasysh në lidhje me një numër situatash, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat u inkorporuan sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut (*Millogoriq dhe të tjerët*, § 44; *Berisha dhe të tjerët*, § 25; *Laliq dhe të tjerët*, § 22).

22. Paneli nuk ka asnjë arsye të largohet nga këto të gjetura.

23. PSSP-ja gjithashtu argumenton se, pasi faktet në këtë rast janë analoge me rastin *Stanishiq*, ku Paneli vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së që i atribuohet UNMIK-ut, Paneli duhet të japë përfundimin e njëjtë në këtë rast. Në mënyrë specifike, PSSP-ja thekson se Paneli në rastin *Stanishiq* tha*:*

> "kërkesa për kompensim e ankuesit ishte një nga rreth 17,000 kërkesat e ngjashme për kompensim, të cilat së bashku krijuan probleme logjistike dhe probleme të tjera për gjykatat e Kosovës. Të gjitha këto kërkesa për kompensim ngritën çështjen e vështirë të imunitetit të UNMIK-ut nga juridiksioni i gjykatave lokale, dhe gjithashtu aplikueshmërinë e ligjit që i bëri autoritetet publike përgjegjëse për akte të caktuara të kryera nga autorët e panjohur. Paneli e pranon, se për shkak të karakteristikave të këtyre kërkesave për kompensim, rasti i ankuesve paraqiti komplikime të caktuara."[1]

PSSP-ja argumenton se ai "nuk sheh asnjë arsye se pse e njëjta linjë e arsyetimit të mos vlejë këtu."

[1] shih PKDNJ, *Stanishiq*, lënda nr. 34/08, mendimi i 22 gushtit të vitit 2012, § 41

24. Ndërsa përmend se kërkesa e ankuesit për kompensim krijon komplikime të ngjashme siç ishin ato në rastin *Stanishiq*, Paneli nuk pajtohet se rastet janë të ngjashme. Në rastin *Stanishiq*, Paneli gjeti se nuk kishte vonesa të rëndësishme nga gjykatat që shqyrtonin rastin në kuadër të kornizës kohore të juridiksionit të Panelit (shih PKDNJ, *Stanishiq*, lënda nr. 34/08, mendimi i 22 gushtit të vitit 2012, §§ 43-49). Në mënyrë specifike, në rastin *Stanishiq*, kërkesa fillestare për kompensim ishte dorëzuar nga ankuesja në Gjykatën Komunale më 15 korrik 2004; më pas, u zhvilluan dy seanca dëgjimore, dhe Gjykata Komunale dorëzoi dy vendime të 23 nëntorit 2006 dhe 22 janarit 2007. Më 11 shtator 2008, Gjykata e Qarkut e dorëzoi vendimin e vet. Megjithatë, në këtë rast, ankesa ishte dorëzuar më 25 maj 2005 dhe deri në fund të vitit 2008 nuk ka pasur seanca dëgjimore të caktuara. Prandaj, ky rast nuk është i ngjashëm me atë *Stanishiq*, pasi në këtë rast ka pasur vonesë domethënëse nga gjykata në shqyrtimin e kërkesës së ankuesit dhe pa ndonjë aktivitet të ndërmarrë nga ajo.

25. Në dritë të kësaj që u tha, Paneli konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së për sa i përket pamundësisë së ankuesit që të ketë përfundimisht vendim për kërkesën e tij për kompensim nga autoritetet kompetente dhe për sa i përket kohëzgjatjes së procedurave.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 13 të KEDNJ-së

26. Paneli konstaton se ankesa sipas nenit 13 të KEDNJ-së (e drejta për kompensim) ka të bëjë para së gjithash me çështjet e njëjta si ato që janë diskutuar sipas nenit 6 § 1. Në këto rrethana, ai konstaton se nuk ngrehet asnjë çështje e veçantë sipas nenit 13 të KEDNJ-së (PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët*, përmendur në § 13 më lart, në § 49).

V. REKOMANDIME

27. Në dritën e gjetjeve të Panelit në këtë rast, Paneli mendon se është e nevojshme ndonjë formë e dëmshpërblimit.

28. Do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i ndalë shkeljet e gjetura dhe t'i korrigjojë aq sa është e mundshme efektet nga kjo. Megjithatë, siç ka theksuar Paneli më lart (shih § 12), përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me administrimin e drejtësisë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozitë të marrë masa që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në procedurat që janë në zhvillim e sipër para gjykatave komunale.

29. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për t'i korrigjuar aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës. Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në situatat me juridiksion të kufizuar të shtetit, Paneli mendon se UNMIK-u duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion të tij *vis-à-vis* autoriteteve kompetente të Kosovës, të marrë siguri që ankesa e dorëzuar nga ankuesi do të shqyrtohet siç duhet (shih PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët* § 49, përmendur në § 13 më lart; krahasoje Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) (Dhoma e Lartë), *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, vendimi i 8 korrikut të vitit 2004, *KEDNJ*, 2004-VII, § 333; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, vendimi i 2 marsit të vitit 2010, § 171).

30. Paneli konsideron më tutje se UNMIK-u duhet t'i ndërmarrë hapat e duhur drejt pagesës së kompensimit adekuat ankuesit për dëmin jomaterial të shkaktuar si rezultat i pezullimit të gjatë të procedurave të krijuara nga ai.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SA I PËRKET PAMUNDËSISË SË ANKUESIT TË KETË VENDIM PËR KËRKESAT E TIJ PËR KOMPENSIM NGA GJYKATAT DHE PËR SA I PËRKET KOHËZGJATJES SË PROCEDURAVE;**

2. **KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOHET ANKESA SIPAS NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

3. **REKOMANDON QË UNMIK-u:**

   a. **T'U KËRKOJË AUTORITETEVE KOMPETENTE NË KOSOVË QË T'I NDËRMARRIN TË GJITHË HAPAT E MUNDSHËM ME QËLLIM TË SIGURIMIT QË PËR RASTIN E ANKUESIT DO TË VENDOSET PA VONESË TË MËTEJME;**

   b. **TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESIT PËR DËMIN JOMATERIAL;**

   c. **TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.**

Andrey Antonov
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues